

# Njoftim përjashtimi nga tarifa e shkollimit - Faza e dytë

## “Për procedurën e përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019”

Njoftojmë studentët që studiojnë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në ciklin e parë me kohë të plotë, se mbështetur në VKM nr. 40 datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në Nr. 269 datë 29.03.2017 “Për Përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”e ndryshuar, ka filluar procedura e aplikimit për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për kategoritë e mëposhtme:

1. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike
2. Student që vjen nga shtresa sociale: Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë
3. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, person me aftësi të kufizuara..
4. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
5. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta.
6. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë
7. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë
8. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
9. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
10. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që janë identifikuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
11. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
12. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë dhe egjiptianë.
13. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

Formulari i aplikimit “PRAKTIKË PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019 – FAZA E DYTË” gjendet në web – site: [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al) rubrika Informacione / njoftime dhe të shkarkohet nga kjo adresë.

Dokumentacioni i përgatitur sipas formularit përkatës të dorëzohet nga vetë studenti në Protokoll - Zyra e e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni kati II Korpusi kryesor deri në datën **18.02.2019**